

Kodi i Sjelljes për Teknologjinë Kompjuterike

1. Të gjithë nxënësit duhet të vishen në **mënyrë të përshtatëshme** në shkollë, siç përcaktohet në Kodin e Veshjes të Shkollës Fillore “Southwark”.
2. Prerazi, nuk lejohet ushqim, çimçakiz, ëmbëlsira, ose pije në Laboratorin Kompjuterik.
3. Nxënësit mund të pijnë ujë në paisjet e ujit , që gjenden jashtë laboratorit, ose të shkojnë në banjo përpara se të futen në Laborator. Asnjë nxënës nuk do të lejohet të largohet nga laboratori gjatë orës së mësimit, përveç rasteve urgjente.
4. Nxënësit do të HYJNE dhe DALIN nga Laboratori Kompjuterik, në RADHE dhe me RREGULL.
5. Nxënësit do të qëndrojnë përpara kompjuterit të caktuar, kur të udhëzohen për këtë qëllim. Nxënësit që nuk janë përpara kompjuterit të caktuar gjatë orës së mësimit, do të marrin notë jo kaluese për këtë periudhë, pavarësisht punës së kryer.
6. Nxënësit duhet të kryejnë të GJITHA aktivitetet e caktuara. Puna e kryer jashtë kohës së caktuar do të skualifikohet, me përjashtim të rasteve kur nxënësi diskuton me Mësuesin e Kompjuterit për çështjen në trajtim. Në tërësi, puna që dorëzohet me vonesë, do të vlerësohet me notë më të ulët.
7. Nuk lejohet ASNJE paisje tjetër elektronike në Laborator (psh, **celular, IPods, video lojra**). Nëse vrotohet përdorimi i tyre, ato do të merren dhe do të jepen në fund të ditës – nëse kjo gjë përsëritet në vazhdim, ato do të merren dhe do të kthehen VETEM te PRINDI i nxënësit.
8. Nxënësit ndalohen të **printojnë**. Printimi do të bëhet vetëm me lejen e mësuesit.
9. Me mbarimin e orës së mësimit, nxënësit duhet të bëjnë mbylljen e kompjuterit (LOG OFF), kur udhëzohen për këtë. Ata vendosin të gjitha materialet e plotësuara në vendin e tyre të caktuar dhe qëndrojnë në dy radhë të drejta dhe të rregullta, në pritje që mësuesi ti drejtojë jashtë mjedisit të Laboratorit Kompjuterik.

Firma e Nxënësit: _____ Data: _____

Firma e Prindit ose Kujdestarit: _____ Data: _____